



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 9
Prishtinë, më 30 janar 2018, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-II-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Verica Çeraniq, Shqipe Pantina, Albert Kinolli, Andin Hoti, Ali Lajçi, Avdullah Hoti, Muharrem Nitaj dhe Zafir Berisha.

Munguan: Faton Topalli dhe Mërgim Lushtaku.

Stafi mbështetës i komisionit: Mehmet Simnica.

Pjesëmarrësit tjerë: Abdullah Haxhiu, Lundrim Camaj dhe Hafiz Krasniqi, KMDK SHA; Vlora Mehmeti, Enver Buqolli, Luljeta Morina, ZKA; Mentor Hyseni, GIZ.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 19.1.2018;
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për raportin financiar vjetor të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës SH.A. për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016;
4. Nxjerrja e rekomandimeve për raportin e auditimit për raportin financiar të Kompanisë Rajonale „Pastërtia” nga Ferizaj, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016;
5. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.1.2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 19.1.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për raportin financiar vjetor të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës SH.A. për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

Kryetari paraqiti para deputetëve disa të dhëna nga raporti i auditimit financiar vjetor të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës SH.A. për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, dhe me këtë e hapi diskutimin.

Vlora Mehmeti, paraqiti në pika të shkurtra disa të dhëna që i përkasin raportit financiar vjetor të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës SH.A. Më tej, theksoi se opinionimi është i kualifikuar dhe për herë të parë kjo kompani është audituar nga ZKA. Të gjitha të gjeturat janë të prezantuara në raport. Me këto të gjetura është pajtuar edhe kompania audituese dhe për këtë kanë përgatitur një plan veprimi, të cilin e kanë dorëzuar në ZKA.

Shqipe Pantina, në cilësinë e raportueses, prezantoi para deputetëve dhe të pranishmëve të gjeturat e këtij raporti. Po ashtu, theksoi se ky është auditim i rregullsisë dhe se opinionimi i auditimit është i kualifikuar. Auditimi është fokusuar në tri çështje kryesore: 1) Pasqyrat financiare vjetore; 2) Qeverisjen; 3) Menaxhimin financiar dhe kontrollin. Po ashtu, ka nxjerrë këto përfundime: Jkorrektësi/gabime në prezantimin e llogarive të farkëtueshme në kontabilitet.

Nuk janë konfirmuar llogaritë e pagueshme për tatim (mungon raporti nga Administrata Tatimore). Mospërputhje e shumave nga të hyrat e grandit të bartur nga vitet e kaluara. Nuk janë evidentuar me kohë ndryshimet. Evidentim jo të saktë të ekuiteteve, nuk është bërë rivlerësimi nga vitet e kaluara. Paraqitje e gabuar e aktives/pasives. Llogaritje e gabueshme e provizionit të borxheve. Ndonëse edhe në vitin 2016, auditori kishte dhënë opinion të kualifikuar të pasqyrave financiare.... “nuk ishin vërejtur se ishin ndërmarrë veprime korigjuese dhe ndarje të provizioneve për borxhet e këqija dhe nuk ka njohur ndonjë provizion për rastet gjyqësore, për shkak të disa padive nga disa furnitorë për mospagesë të borxheve”. Dobësi të theksuar në llogaridhënie, menaxhim të rrezikut dhe në cilësi të raportimit menaxherial. Mungon auditimi i brendshëm i cilësisë së lartë. KMDK nuk kishte arritur të zbatojë rekomandimet e dhëna në raportin e auditimit të jashtëm për vitin 2015, si dhe nuk kishte përgatitur ndonjë plan për menaxhim të rrezikut. Plani biznesit nuk i mbulon të gjitha aktivitetet dhe përmbajta e tij nuk reflekton mundësit reale të ndërmarrjes. Auditori i brendshëm nuk kishte afuar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontroleve të brendshme dhe nuk kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre. KMDK nuk kishte përgatitur një plan veprimi, ku paraqitet mënyra se si do të implementohen rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit për vitin 2016, asnjë nga 3 rekomandimet e dhëna nuk janë zbatuar ende. Kontrollat mbi menaxhimin e përgjithshëm të KMDK-së kanë nevojë për përmirësime. Auditimi ka vënë në pah mangësi lidhur me pajtueshmërinë me ligje. Buxheti fillestar për investime kapitale,

krahasuar me atë final, tregon trend ulës për 50% dhe ky është një tregues i planifikimit jo të duhur për këtë kategori. Keqmenaxhim në shpenzimet për paga dhe mëditje, procedurat e rekrutimit në papajtueshmëri me ligjin, mungese transparencës, konkurrencës dhe trajtim të barabartë në punësim. Mungonte raporti i pranimit të mallrave, miratimi paraprak i kërkesave për blerje, mungonte vendimi për limitimin e shpenzimeve. Keqmenaxhim i buxhetit në të gjitha kategoritë. Keqmenaxhim i të hyrave në të gjitha kategoritë (licencimi i deponive sanitare, caktimi i tarifave për mbledhjen e mbeturinave). Mangësitë në faturimin e të hyrave. Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike të thërrasë në raportim bordin drejtues të kompanisë për të shpjeguar defektet dhe për të raportuar me të arriturat në proces të zbatimit të rekomandimeve të auditorit. Po ashtu, propozoi rekomandim që Zyra Kombëtare e Auditorit të bëjë auditim të performancës. Po ashtu, theksoi se janë përgatitur disa rekomandime që do të duhet të miratohen nga komisioni dhe t'i dërgohen përfaqësuesve të KRMDK-së, për të përgatitur një plan veprimi për adresim të rekomandimeve.

Lundrim Camaj, më lejoni që fillimisht t'ju falënderoj për ftesën në këtë komision. Ne, si Bord i Drejtorëve të KMDK-së, jemi emëruar me vendimin nr. 02/50 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në këtë rast aksionarit, të datës 23/09/2015. Në përbërje: Lundrim Camaj, kryesues, Xhavit Hasani, Hafiz Krasniqi, Goran Laziqi, Nexhat Berisha dhe Gazmend Bytyçi, anëtarë. Me marrjen e detyrës, ne jemi njoftuar nga kryeshefi ekzekutiv për gjendjen e kompanisë, se si ka qenë para falimentimit, dhe që nga viti 2012, për çdo vit, kompania ka shënuar progres financiar dhe operativ, kurse viti 2016, edhe përkundër vështirësive nga trashëgimia e borxheve, siç ishte rasti i ish-kontraktorit "Alpenbau" nga viti 2007-2009, prapë ia ka dalë ta përmbyllë vitin 2016, me rezultate pozitive, që theksohen edhe nga vetë raporti i auditimit të ZKA-së. Vlen të theksohet se që nga emërimi, si bord, kemi raporte dhe bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë, si me menaxhmentin, ashtu edhe me Njësinë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike-MZHE. Si bord, konform detyrave, kemi mbikëqyrur punën e menaxhmentit, si dhe kemi marrë vendime të rëndësishme për kompaninë, brenda suazave ligjore, siç janë miratimi i planit të biznesit, raportet tremujore, raportet vjetore etj. Gjithherë, duke e njoftuar me kohë edhe përfaqësuesin e aksionarit, pra Njësinë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike në MZHE, që e falënderojmë për korrektësinë dhe bashkëpunimin e shkëlqyer që kemi pasur gjatë gjithë kësaj kohe. Vetëm gjatë vitit 2016, si bord, kemi mbajtur gjithsej 16 mbledhje, prej tyre 12 mbledhje të rregullta, 3 mbledhje të jashtëzakonshme dhe 1 mbledhje të përgjithshme vjetore me aksionarin.

Po ashtu, edhe përkundër vështirësive, qoftë në aspektin financiar dhe operativ që kemi pasur gjatë vitit 2016, ku jemi ballafaquar me një obligim (borxh) të trashëguar që nga 2008, vitin 2016 kemi arritur ta përmbyllim me sukses, ku plani i biznesit është tejkaluar për 13.48 %. Pra, kemi pasur një progres të jashtëzakonshme. Sa i përket raportit të auditimit për vitin 2016, ne jemi audituar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, kemi pasur një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me auditorët e ZKA-se dhe i falënderojmë për punën dhe bashkëpunimin. Meqë auditimi është kryer nga kjo zyrë, draft-raportin e ZKA-së e kemi pranuar më 16 maj 2017, ku kemi pasur afat 15 ditë për dhënien e komenteve. Menaxhmenti ka përgatitur komentet dhe ua ka përcjellë ZKA-se, kurse Zyra Kombëtare e Auditimit ka përcjellë draftin final te ne, më datë 9.6.2017. Pas pranimit të këtij raporti të auditorit për pasqyrat financiare të auditura për 2016, Komisioni i Auditimit, më datë 15.06.2017, ka mbajtur mbledhjen e rregullt, ku ka shqyrtuar këtë raport dhe i ka rekomanduar bordit për miratim.

Pas kësaj, bordi, më datë 19.6.2017 ka shqyrtuar në mbledhjen e rregullt këtë raport të auditimit të bërë nga ZKA-ja dhe konform kërkesave të këtij raporti, kam kërkuar nga menaxhmenti, që ta hartojë planin e veprimit, me qëllim të përmbushjes së rekomandimeve të këtij raporti. Menaxhmenti ka hartuar planin dhe ia ka dorëzuar ZKA-së, ku shumica e rekomandimeve janë përmbushur, sidomos ato teknike dhe procedurale. Po ashtu, kam kërkuar edhe nga Komisioni i Auditimit, që të analizojë të gjeturat e këtij raporti, që kanë të bëjnë me anën financiare dhe

përmbushjen e gjithë këtyre kërkesave të këtij raporti të auditimit. Në përgjithësi, raporti ka një vlerësim pozitiv dhe konstaton se nuk ka të shkelura materiale. Opinioni i këtij raporti është opinioni i kualifikuar, pavarësisht se ne nuk jemi pajtuar me disa të gjetura dhe menaxhmenti, përmes komenteve i ka argumentuar se nuk qëndrojnë disa prej tyre, prapëseprapë nuk janë përfshirë në draftin final të këtij raporti, andaj ne e kemi miratuar si të tillë këtë raport dhe kemi marrë zotimin se do të bëjmë të gjitha përpjekjet e domosdoshme ligjore e profesionale që t'i përmbushim këto rekomandime dhe për vitin tjetër ta kemi një raport me një opinion edhe më pozitiv.

Por, duke ditur natyrën e punës së KMDK-së dhe problemet me të cilat ballafaqohet ndërmarrja, për ne si bord dhe menaxhment, shqetësim mbetet trajtimi i ujërave të zeza në deponinë sanitare të Mirashit, mbledhja e borxheve nga kompanitë rajonale të mbeturinave (KRM-të), si dhe ngritja e tarifës së shërbimeve, ku kemi bërë kërkesa disa herë. Këto shqetësime janë shprehur çdoherë edhe në raportet e ndërmarrjes, të cilat i janë përcjellë aksionarit dhe ministrive përkatëse.

Abdullah Haxhiu, po ashtu theksoi sfidat që ka kjo kompani, përpjekjet që ka bërë për të përmirësuar gjendjen brenda kompanisë. Në vitin 2014, kjo kompani ishte në prag të falimentimit, ndërsa tani operon mirë dhe është një kompani mjaft stabile. Të gjeturat e auditorit jemi munduar t'i adresojmë. Ne kemi përgatitur një plan veprimi, të cilin po ua jap tani.

Avdullah Hoti, theksoi se është shqetësuese mosadresimi i rekomandimeve nga viti paraprak, problemet me menaxhimin e parasë së imët, si dhe regjistrimi i pasurive dhe menaxhimi i borxheve lënë dyshime për një menaxhim jo të mirë të parasë publike.

Abdullah Haxhiu, po ashtu u përgjigj në të gjitha pyetjet e parashtruara nga deputetët.

Kryetari theksoi se pasi që një numër i madh i rekomandimeve është dhënë nga ana e auditorit, le të kuptohet se brenda kompanisë KRMDK nuk ka pasur menaxhim të mirë. Ne kemi përgatitur disa rekomandime për menaxhmentin e kompanisë si vijon: KMDK. SH.A. në afatin kohor brenda një muaji, të përgatisë raport lidhur me adresimin e rekomandimeve nga të gjeturat e raportit të auditimit për PVF-të e KMDK-së. SH.A. për vitin 2016, për këtë, me raport me shkrim ta njoftojë KMFP-në. Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet se kontrollet menaxheriale duhet të përforcohen dhe zbatimi i tyre duhet të monitorohet në vazhdimësi. Bordi i Drejtorëve duhet të fuqizojë Komitetin e Auditimit të Brendshëm dhe Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, me qëllim që të forcojë kontrollin e brendshëm, brenda vetë kompanisë. Kryeshefi ekzekutiv duhet të sigurohet që evidenca e pasurisë të jetë e saktë dhe e prezantuar drejt në PVF-të e KMDK-së. Kryeshefi ekzekutiv duhet të sigurohet se rekrutimi i stafit, evidenca e të hyrave, prezantimi i shpenzimeve, si dhe zbatimi i sistemit të prokurimit publik, respektohet në përpikëri, sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë. Me këtë mbylli iskutimin për këtë pikë.

Përfundim

KMFP vendosi që raportin e audituar financiar vjetor të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës SH.A. për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të mos e adresojë për seancë plenare, ndërsa rekomandimet do t'i adresohen menaxhmentit të KMDK-së.

4. Nxjerrja e rekomandimeve për raportin e auditimit për raportin financiar të Kompanisë Rajonale “Pastërtia” nga Ferizaj, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

Kryetari theksoi se në javën e kaluar është diskutuar ky raport, ku raportues për këtë raport ishte deputetja Verica Çeraniq, tani po lexoj vetëm rekomandimet. KRM “Pastërtia” në Ferizaj, brenda një muaji, të përgatisë raport lidhur me adresimin e rekomandimeve nga të gjeturat e raportit të auditimit për PVF-të e KRM-së, për vitin 2016. Po ashtu, ta njoftojë me raport me shkrim KMFP-në. Kryesuesi i bordit duhet të ndërmarrë hapa shtesë, me qëllim të sigurimit të licencës dhe caktimit të tarifave nga organet kompetente. Bordi i Drejtorëve duhet të fuqizojë Komitetin e Auditimit të Brendshëm dhe Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, me qëllim të forcimit të kontrollit të brendshëm, brenda vetë kompanisë. Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm janë duke ecur mirë. Kontrollet menaxheriale duhet të përforcohen dhe implementimi i tyre duhet të monitorohet në vazhdimësi. Kryeshefi ekzekutiv duhet të sigurohet se rekrutimi i stafit dhe menaxhimi i personelit po bëhet në pajtim të plotë me legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë.

Përfundim

KMFP vendosi që raportin e audituar financiar vjetor të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave “Pastërtia” nga Ferizaj, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të mos e adresojë për seancë plenare, ndërsa rekomandimet do t’i adresohen menaxhmentit të KRM-së.

5. Të ndryshme

Kryetari njoftoi deputetët për një shkresë të Agjencisë Kundër Korrupsionit, për zbatimin e nenit 80 të LMFP. Po ashtu, propozoi që në një takim të radhës, të ftohet ministri i Financave për të raportuar për këtë pikë. Ndërsa, takimi i grupit punues për Projektligjin për kontrollin e brendshëm financiar, të mbahet të enjten, më datë 2.2.2018, duke filluar nga ora 10.00. Po ashtu, për takimin e radhës së komisionit, ku planifikohet të mbahet më datë 7.2.2018, duke filluar nga ora 10.00, ku do të diskutohet shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Shëndetësisë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e SHSKUK-së, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016 dhe shqyrtimi i raportit të performancës për efikasitetin dhe efektivitetin në implementimin e sistemit informativ unik të integruar shëndetësor. Me këtë mbylli takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj